



K.DH.SH.II.nr.956/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetari i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “D...” me seli në Ferizaj, e përfaqësuar nga Shoqëri e Avokateve SCLR Partners shpk me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1133/19 të datës 13.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.01.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit NTP “D...” me seli në Ferizaj, e datës 15.03.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1133/19, i datës 13.04.2021, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/4140, i datës 17.04.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe i ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin aprovohet e bazuar ankesa e paditësit NTP “D...” me seli në Ferizaj, anulohet në tërësi aktgjykimi A.nr.1133/19 i datës 13.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/4120 i datës 14.04.2019.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/4140 i datës 17.04.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, NTP “D....” me seli në Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimit R-6768/28.03.2019 të ZBD Ferizaj si e pa bazuar.

Me të cilin aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror, subjektit në procedurë, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas deklaratës doganore të lartcekura, duke caktuar bazë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të zhdoganimeve të mëhershme.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 13.04.2021, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/4140 datë 17.04.2019. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se “Pretendimi i paditësit për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, po ashtu sipas vlerësimit të gjykatës nuk është i qëndrueshëm, sepse në rastin konkret nga ekzaminimi i provave në shkresat e lëndës nuk është dëshmuar se vlera e deklaruar e mallit është çmim realisht i paguar. Në këtë drejtim gjykata konstaton se paditësi për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor, Deklaratës Unike Doganore me nr.R-6768/28.03.2019 i ka bashkangjitur faturën me nr.XL20190223 të datës 23.02.2019, të lëshuar nga eksportuesi “.....” co.LTD nga Hongkonku – Kina, në shumë prej 27,139.56 USD, urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të datës 15.11.2018 dhe atë të datës 25.02.2019, të cilat janë bërë në llogari të subjektit “.....” CO LTD nga Kina në shumë prej 27,1240.00USD, ne përshkrimin bankar “pagese e mallit”. Në këtë situatë gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e pagesave bankare me vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, sepse siç rezulton edhe nga kontrata e shitblerjes e datës 27.02.2019, dhe faturat e blerjes së mallit ne nr.XL20190223 të datës 23.02.2019 të paraqitura si provë nga paditësi, malli lëndor është blerë prej shitësit – eksportuesit “.....” CO.LTD nga Hongkongu – Kina, ndërsa pagesa bankare i është bërë subjektit tjetër “.....” CO LTD nga Kina i cili nuk është eksportues i mallit lëndor në rastin konkret. Gjykata thekson se për tu pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 paragrafi 1 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilin ia ka paguar shitësit- eksportuesit të mallit lëndor ”.....” CO.LTD nga Hongkongu – Kina”

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222,

në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se e paditura ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Kodit Doganor me rastin e nxjerrjes së aktvendimit të lartcekur. Këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se paditësi nuk ka prezantuar fakte të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale të mallit sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, në këtë rast është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit - eksportuesit të mallit “.....” CO.LTD nga Hongkongu – Kina. Paditësi edhe në paditë e datës 13.05.2019 të ushtruar ndaj aktvendimit nr.01.3.2.2/4140 të doganës së Kosovës, por edhe në ankesën e datës 05.07.2022 të ushtruar ndaj aktgjykimit A.nr.1133/2019 i datës 13.04.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, nuk ka mundur të dëshmoj me prova konkrete se pagesa bankare i përket faturës së mallit lëndor, pasi që transaksioni bankar të rubrika detalet e pagesës nuk përmban numrin e faturës dhe emrin e eksportuesit për pagesën e mallit lëndor me të cilat prova paditësi do të dëshmohej vlerën e vërtet të mallit e paguar konform nenit 33 të KDAK-së i cili nen parasheh që *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*.

Prandaj, nga kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, sepse paditësi në procedurë ankimore tek e paditura, por edhe para gjykatës nuk ka paraqitur prova me të cilat dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Pra, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, dhe nenin 46 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me pretendimet e paditësit se dogana nuk ka arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e prezantuara të cilat dëshmojnë vlerën e transaksionit por e ka rivlerësuar një pjesë të mallit sipas metodës së gjashtë të vlerësimit të mallit. Ky vlerësim i mallit është në kundërshtim me nenin 234.1 të Kodit doganor, kjo për faktin se vlera e mallit mund të rivlerësohet vetëm në rastin kur vlera e tij nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33–vlerës së transaksionit. Në rastin konkret të gjitha dokumentet e mallit sidomos transaksionet bankare të bërë sipas faturës janë bazë e mjaftueshme për të përcaktuar vlerën e mallit sipas nenit 33 të Kodit Doganor. Këtë pretendim të paditësit kolegji i kësaj gjykate e vlerëson si të paqëndrueshme për faktin se transaksionet bankare të bashkangjitura në shkresat e lëndës nuk përmbajnë në përshkrim numrin e faturës dhe nuk janë

bërë ne emër te eksportuesit të mallit lëndor, andaj nuk ka arritur të dëshmoj pagesat e mallit lëndor si dëshmi se është deklaruar vlera e mallit doganor. Andaj, kolegji vlerësoj se e paditura në rastin konkret ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit përkatësisht nenin 35 të Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të zhdoganimeve të mëhershme. Sa i përket pretendimeve të paditësit se Dogana e Kosovës fare nuk ka marr parasysht që të njëjtin mall të importuar më herët e ka aprovuar vlerën e deklaruar, ne rrethanat e rastit konkret dhe pas ekzaminimit te aktgjykimit te ankimuar kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhe dhënë arsye te mjaftueshme si dhe ka shqyrtuar pretendimet dhe provat e bashkangjitura padisë se paditësit, dhe ka konstatuar se pagesat nuk përmbajnë numrin e faturës për mallin lëndor siç pretendon paditësi. Tutje, kolegji konsideron se pagesat te cilat gjenden ne shkresa të lendes të rubrika detalet e pagesës nuk përmban numrin e faturës për pagesën e mallit lëndor, dhe ne këtë drejtim gjykata nuk mund te identifikoj se a është bërë pagesa për mallin lëndor, andaj, kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vlera e mallit kontestues është vlerë reale pasi qe paditësi nuk ka paraqitur prova bindëse dhe konkrete për mënyrën e pagesës se mallit lëndor.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysht se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.956/22 me datë 20.01.2023

**Kryetari kolegjit,  
Ramush Bardiqi**